

V E N D I M
Nr. 162, datë 13.4.2000

**PËR SHPËRNDARJEN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË
SHOQËRISË “UNIVERSI”, SH.P.K. NË ADMINISTRIM, PËR MBYLLJEN E
PROCESIT TË ADMINISTRIMIT DHE PËR KALIMIN E DOKUMENTACIONIT
FINANCIAR ORGANIT TË HETIMIT**

(Ndryshuar me vendimin nr. 522, datë 8.7.2005)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 6, të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, dhe të neneve 3, 4 e 8, pika 3, të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I:

1. Fillimin e procesit të shpërndarjes së vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi”, sh.p.k. në administrim, në bazë të të ardhurave financiare, të grumbulluara nga shitja e aseteve në ankandin publik.

2. Shuma e detyrimit të mbetur që shoqëria “Universi” sh.p.k., në administrim ka ndaj kreditorëve është 242 469 153 lekë.

Të ardhurat financiare për shpërndarje, të grumbulluara nga shitja e aseteve dhe ato gjendje të depozituara në bankë kapin shumën 96 000 000 lekë.

Koeficienti i kthimit të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, për të gjithë kreditorët është: 0.40 ose 40 për qind.

3. Ngarkohet *Banka Kombëtare Tregtare* me shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Universi” sh.p.k., në administrim.

Shpenzimet për shërbimet që do të kryhen në sportelet e *Banka Kombëtare Tregtare* të përballohen nga zëri “Shpenzime” në buxhetin për vitin 2000 të Grupit të Mbikëqyrjes.

4. Dokumentacioni i ekspertimit kontabël dhe i administrimit të shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, t’i dorëzohet organit të hetimit.

5. Ngarkohen *Banka Kombëtare Tregtare*, Grupi i Mbikëqyrjes dhe administratori i shoqërisë “Universi” sh.p.k. në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta